

LIGJ
Nr.7866, datë 6.10.1994

PËR REFERENDUMET

Në mbështetje të neneve 3, 16 dhe 28, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Presidentit të Republikës,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Referendumi është një nga format e ushtrimit të pushtetit nga populli nëpërmjet votimit të përgjithshëm, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.

Neni 2

Referendumi mund të vendoset për të miratuar Kushtetutën dhe amendamentet e saj, si dhe çështje të tjera me rëndësi të veçantë kombëtare që lidhen me pavarësinë, integritetin e Republikës së Shqipërisë si dhe për çështje të tjera madhore. Referendumi mund të vendoset edhe për çështje të rëndësishme të njësive administrative-tokësore të vendit me kusht që të mos cenojnë karakterin unik kombëtar të shtetit shqiptar.

Neni 3

Referendumet, në varësi nga natyra e tyre, mund të jenë të përgjithshme ose të pjesshme.

Referendumet e përgjithshme zhvillohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe marrin pjesë të gjithë shtetasit shqiptarë me të drejtë vote.

Referendumet e pjesshme zhvillohen në një ose disa njësi administrative-tokësore të Republikës së Shqipërisë në të cilat marrin pjesë shtetasit shqiptarë me të drejtë vote, me banim të përhershëm në këto njësi.

Neni 4

Të drejtën për të marrë pjesë në referendum e kanë të gjithë shtetasit shqiptarë që ditën e votimit kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

Përgjashtohen nga kjo e drejtë shtetasit që iu është hequr zotësia për të vepruar.

Neni 5

Iniciativa për të kërkuar thirrjen e referendumit i takon Presidentit të Republikës, i cili propozimin ia dërgon Kuvendit Popullor për të vendosur. Vendimi merret me shumicë votash.

Neni 6

Referendumi shpallet nga Presidenti i Republikës me dekret të veçantë, menjëherë pas marrjes së vendimit nga Kuvendi Popullor. Dita e referendumit caktohet në dekret në një ditë pushimi të zakonshme brenda dyzetepesë ditëve nga shpallja e tij.

KREU II ORGANIZIMI I REFERENDUMIT

Listat elektorale

Neni 7

Votimi për referendumin bëhet mbi bazën e listave elektorale.

Në këto lista regjistrohen të gjithë shtetasit që kanë të drejtë të marrin pjesë në referendum dhe që kanë banim të përhershëm ose të përkohshëm në zonën ku zhvillohet referendumi.

Organi kompetent kur regjistron në territorin e tij shtetas me banim të përkohshëm, është i detyruar të njoftojë organin përkatës të vendbanimeve të tyre me qëllim që këta të mos regjistrohen në dy vende.

Neni 8

Listat e shtetasve, që kanë të drejtë të marrin pjesë në referendum, përpilohen nga organet përkatëse të pushtetit lokal. Ato duhet të përmbajnë emrin, atësinë, mbiemrin dhe datëlindjen e votuesit, si dhe zonën e votimit dhe numrin e qendrës së votimit. Listat nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari i organit ekzekutiv të pushtetit lokal.

Neni 9

Listat elektorale shpallen në vende publike nga organi që i ka hartuar, jo më vonë se 15 ditë para ditës së referendomit.

Komisionet dhe qendrat e votimit

Neni 10

Votimi dhe numërimi i votave bëhet në qendrat e votimit.

Neni 11

Qendrat e votimit caktohen jo më vonë se 20 ditë para ditës së referendomit.

Qendrat e votimit krijohen me vendim të organeve përkatëse ekzekutive të pushtetit lokal.

Neni 12

Për organizimin dhe zhvillimin e referendomit krijohen:

1. Komisioni Qendror i Votimeve.
2. Komisionet e komunave, bashkive dhe rretheve.
3. Komisioni i qendrës së votimit.

Neni 13

Komisioni Qendror i Votimeve:

a) kujdeset për zbatimin e njëllotë dhe të përpiktë të këtij ligji gjatë zhvillimit të referendomit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) ushtron drejtimin metodologjik dhe kontrollon veprimtarinë e komisioneve të votimeve të rretheve, të bashkive e të komunave;

c) Shqyrton ankimet kundër veprimeve dhe akteve të paligjshme të komisioneve të zgjedhjeve;

ç) vendos rregulla për praninë në zhvillimin e referendomit të vëzhguesve të brendshëm dhe të huaj dhe u jep atyre dokumentin e identifikimit;

d) nxjerr rezultatet përfundimtare të referendomit në shkallë vendi.

Neni 14

Komisionet e komunave, bashkive dhe rretheve:

- a) kujdesen për zbatimin e njëlojtë dhe të përpiktë të këtij ligji gjatë zhvillimit të referendumit në territorin e tyre;
- b) ushtrojnë kontroll mbi veprimtarinë e qendrave të votimit gjatë zhvillimit të referendumit;
- c) pajisin komisionet e qendrave të votimit me kuti votimi, fletët e votimit dhe materiale të tjera të nevojshme për zhvillimin normal të referendumit;
- ç) numërojnë votat mbi bazën e procesverbaleve të qendrave të votimit dhe shpallin rezultatet e referendumit në zonë;
- d) shqyrtojnë ankimet kundër veprimeve dhe akteve të paligjshme të komisioneve të qendrave të votimit dhe marrin vendimet përkatëse.

Neni 15

Komisioni i qendrës së votimit:

- a) siguron zhvillimin e lirë dhe normal të votimit në përputhje me ligjin;
- b) siguron mbajtjen e regullit gjatë votimit;
- c) numëron votat e hedhura në kutitë e votimit;
- ç) përgatit dhe dorëzon në komisionin e rrethit, komunës ose të bashkisë dhe të rrethit procesverbalin e votimit;
- d) regjistron në procesverbal ankesat dhe kërkesat e anëtarëve të komisionit apo të votuesve, i shqyrton ato dhe merr vendimin përkatës.

Neni 16

Për organizimin dhe zhvillimin normal të referendumit, për të gjitha rregullat që kanë të bëjnë me listat e votuesve, zonat, qendrat e votimit dhe kompetencat e tyre zbatohen dispozitat ligjore të prashikuara në kreun II të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal". Për çdo qendër votimi ngrihet komisioni i përbërë nga kryetari, sekretari dhe nga një përfaqësues i subjekteve politike që përfaqësohen në pushtetin lokal. Kur numri i përgjithshëm del çift, shtohet një anëtar pa parti.

Ankimet kundër vendimeve të komisioneve

Neni 17

Kundër vendimeve të komisioneve të komunave e bashkive mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve nga shpallja e tyre në komisionin e rrethit, i cili merr vendimin përkatës.

Kundër vendimeve të komisionit të votimit të rrethit mund të bëhet ankim në Komisionin Qendror të Votimeve.

Komisioni Qendror i Votimeve pasi shqyrton ankimet e paraqitura, merr vendim brenda 3 ditëve.

Neni 18

Kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Votimeve mund të bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese brenda 2 ditëve nga shpallja e tyre.

Gjykata Kushtetuese shqyrton ankimin dhe brenda 3 ditëve merr vendim për shpalljen përfundimtare të rezultatit të referendumit, i cili është i formës së prerë.

Propaganda

Neni 19

Shtetasit, partitë politike, organizatat, kanë të drejtë të bëjnë propagandë në favor të alternativës të zgjedhur prej tyre.

Neni 20

Ndalohet propaganda një ditë përpara dhe ditën e referendumit.

Neni 21

Për vendin e zhvillimit të propagandës zbatohen nenet 41-48 të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992.

Fletët e votimit

Neni 22

Fletët e votimit të referendumit shtypen në të njëjtat përmasa, me ngjyrë të njëjlojtë e përbërje të njëjtë të letrës.

Neni 23

Fletët e votimit të referendumit u shpërndahen komisioneve të zonave në një masë plus dy për qind të numrit të votuesve të regjistruar në listat përkatëse.

Neni 24

Modeli i fletës së votimit të referendumit caktohet nga Këshilli i Ministrave.

KREU III

REFERENDUMI DHE NXJERRJA E REZULTATEVE TË TIJ

Votimi

Neni 25

Votimi për referendumin bëhet në mjedise të caktuara nga organet ekzekutive të pushtetit lokal.

Neni 26

Votimi për referendumin bëhet në ditën e caktuar nga ora 8.00 deri në orën 20.00.

Neni 27

Në fletën e votimit të referendumit, shtetasi që voton lë pa prekur atë alternativë në favor të së cilës është, duke i vënë vizë alternativës tjetër.

Neni 28

Për votimin për referendumin zbatohen të njëjtat rregulla që parashikohen në nenet 65, 66, 67, 68, 71 dhe 72 të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal".

Numërimi i votave

Neni 29

Menjëherë pas përfundimit të votimit, kryetari i komisionit të qendrës së votimit e shpall votimin të përfunduar.

Para fillimit të numërimit të votave, kryetari i qendrës së votimit mënjanon fletët e votimit të papërdorura, shpall numrin e tyre duke i shënuar në procesverbal. Pas kësaj hap kutinë e votimit dhe nxjerr prej andej të gjitha fletët e votimit. Në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit bëhet numërimi

i fletëve të votimit të vlefshme dhe të pavlefshme duke i pasqyruar ato në procesverbal.

Neni 30

Fletët e votimit janë të pavlefshme kur:

- a) nuk i përgjigjen kërkesave lidhur me formën, madhësinë, ngjyrën, përbërjen e letrës, përmbajtjes dhe vulosjen;
- b) janë dëmtuar aq shumë sa nuk mund të përcaktohet vullneti i shprehur nga votuesi;
- c) nuk i është vënë vizë asnjërit nga variantet e përgjigjes ose i është vënë vizë të dy varianteve.

Neni 31

Në përfundim të referendumit kryetari i qendrës së votimit harton procesverbalin, i cili përmban:

- a) numrin e qendrës së votimit dhe të zonës;
- b) numrin e përgjithshëm të shtetasve të regjistruar për votim në qendrën e votimit;
- c) numrin e fletëve të votimit të dhëna në ditën e referendumit;
- ç) numrin e votuesve sipas shënimeve në lista;
- d) numrin e fletëve të votimit që ndodheshin në kutitë e votimit pas nxjerrjes së tyre;
- e) numrin e fletëve të votimit të vlefshme;
- ë) numrin e fletëve të votimit të pavlefshme;
- f) numrin e votave që janë dhënë në favor të Kushtetutës, amendamentit apo çështjes për të cilën është zhvilluar referendumi;
- g) numrin e votave që janë dhënë kundër Kushtetutës, amendamentit apo çështjes për të cilën është zhvilluar referendumi;
- h) vërejtjet dhe ankesat e paraqitura në komision dhe vendimet për to.

Procesverballi hartohet në dy kopje dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të qendrës së votimit dhe duhet të përmbajë vulën përkatëse. Ai anëtar që nuk është dakort me procesverbalin ose me pjesë të tij, ka të drejtë të shënojë në procesverbal vërejtjet e veta.

Neni 32

Komisioni i qendrës së votimit i dërgon komisionit të komunës a të bashkisë dy kopje të procesverbalit të mbajtur, së bashku me fletët e votimit, vulën dhe listat e votuesve. Këto materiale dorëzohen nga kryetari dhe sekretari i qendrës së votimit, të shoqëruar nga një punonjës policie, brenda 24 orëve nga përfundimi i referendumit.

Neni 33

Komisioni i komunës a bashkisë mbi bazën e të dhënave të procesverbaleve të qendrave të votimit, nxjerr rezultatin përmbljedhës dhe i pasqyron ato në një procesverbal i cili përmban kërkesat e renditura në nenin 32 të këtij ligji. Procesverballi në dy kopje, së bashku me listat e zgjedhësve, fletët e votimit dhe vulat i dërgohen komisionit të rrethit.

Neni 34

Komisioni i rrethit, me të marrë procesverbalet e komunave dhe të bashkive, nxjerr rezultatin përfundimtar dhe harton një procesverbal, i cili përmban:

- a) numrin e përgjithshëm të shtetasve të regjistruar për votim në të gjithë territorin e rrethit;
- b) numrin e përgjithshëm të shtetasve që kanë votuar;
- c) numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit të hedhura në kuti;
- ç) numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit të pavlefshme;
- d) numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit të vlefshme;
- e) numrin e votave që janë dhënë në favor të Kushtetutës, amendamentit e çështjes për të cilën

është zhvilluar referendumi;

ë) numrin e votave që janë dhënë kundër Kushtetutës, amendamentit a çështjes për të cilën është zhvilluar referendumi;

f) vërejtjet dhe ankesat e ardhura në komision, si dhe vendimet e marra për to.

Procesverbali hartohet në dy kopje, nga të cilat njëra i dërgohet Komisionit Qendror të Votimeve brenda 2 ditëve nga përfundimi i referendumit, ndërsa tjetra ruhet në komisionin e rrethit.

Neni 35

Komisioni Qendror i Votimeve pas marrjes së procesverbaleve nga komisionet e rretheve, nxjerr rezultatin përfundimtar, i cili pasqyrohet në një procesverbal të veçantë që përmban të dhënat e treguara në nenin 34.

Neni 36

Kushtetuta, amendamenti apo çdo çështje tjetër për të cilën është zhvilluar referendumi quhet e pranuar kur për të kanë votuar pro më shumë se 50 për qind e shtetasve që morën pjesë në votime, me kusht që numri i këtyre të fundit të jetë më i madh se 50 për qind e numrit të shtetasve të regjistruar në listat elektorale.

KREU IV PËRGJEGJËSIA PËR SHKELJEN E KËTIJ LIGJI

Neni 37

Personat që me anë të dhunës, mashtrimeve, kërcënimeve apo çfarëdo mënyre tjetër pengojnë shtetasin për të marrë pjesë ose jo në referendum ose e shtrëngojnë atë për të votuar pro ose kundër, dënohen me gjobë ose me heqje lirie deri në tre vjet.

Neni 38

Paraqitja në dokumentin e referendumit të të dhënave, rrethanave, shifrave që dihen se janë të pasakta, përpilimi i dokumenteve falco ose zëvendësimi i të saktave me të rreme, i bërë nga personat e ngarkuar në përpilimin, vlerësimin, nxjerrjen e rezultateve apo ruajtjen e dokumenteve, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 39

Shkelja e rregullave të tjera të parashikuara në këtë ligj përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 1000 deri në 10000 lekë. Vendimet jepen nga komisionet përkatëse të votimeve.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 40

Shpenzimet për organizimin dhe zhvillimin e referendumit përballohen nga shteti.

Neni 41

Këshilli i Ministrave ngarkohet për sigurimin e bazës materiale financiare, si dhe marrjen e masave organizative për zhvillimin normal të referendumeve.

Neni 42

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.932, datë 7.10.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.